

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE TETOR 2025

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesë	Tarifa
26	01.10.2025	Pershendetje, jam studente ne vitin e pare universitet ne Universitetin e Mjekesise Tirane. Gjimmazin e kam mbaruar si nje nxenese ekselente. Degjova rreth burses suaj te ekselences ndaj po ju kontaktoj per te marre me shume informacion si funksionon dhe kush e perfiton. Faleminderit per kohen tuaj!	09.10.2025	Pershendetje, Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 01.06.2022, të ndryshuar, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, pikës 2 Mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit e përfitojnë studentet , që nuk janë njëkohësisht përfitues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar dhe që plotësojnë kriteret e mëposhtme: Studenti me notë mesatare në pranim, që: - ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00; -në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plote	Jo
27	03.10.2025	Pershendetje ! Jam nje studente ne vitin e trete sijet bachelor biologji , ne universitetin Ismail Qemali Vlore qe kam perfituar bursen prioritare vitin e pare dhe te dyte. Jam e interesuar a do te hidhet bursa per studentet kete vit ? Pres pergjigjen tuaj , faleminderit!	09.10.2025	Pershendetje Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 01.06.2022, të ndryshuar, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”; Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar; Marrëveshjes trepalëshe të nënshkruar ndërmjet Studentëve, IAL-ve dhe AKFAL-it; Ju bëjmë me dije se për studentët që vijnë në përfitojnë mbështetje financiare për vitin akademik 2025-2026, është e nevojshme të depozitoni pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë dokumentacionin si më poshtë: Listën e notave për vitin akademik 2024-2025; Vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për vitin akademik 2024-2025. Në rast se nuk plotësohet kriteri i notës mesatare, studenti humbet të drejtën e përfitimit të mbështetjes financiare për vitin akademik pasardhës. Depozitimi i dokumentacionit duhet të kryhet në një nga mënyrat e mëposhtme: fizikisht pranë zyrave të AKFAL-it, në format elektronik, në adresën: adresën e e-mailit: enkelejda.meta@arsimi.gov.al në rrugë postare, në adresën: “Rruga Naim Frashëri, Nr. 34, Tiranë”, Afati i dorëzimit të dokumentacionit , brenda datës 24.10.2025. Faleminderit për bashkëpunimin.	Përgjigjia jepet e plote	Jo
28	07.10.2025	Pershendetje, Une nje student i fakultetit te Historise dhe Filologjise, ne programin e Historise, viti III. Jam prej dy vitesh perfitues i burses per programet prioritare. Vitin e kaluar, afersisht ne kete kohe, mu kerkua nga ju depozitimi i nje liste notash dhe nje vertetimi per shlyerjen e detyrimeve te vitit I, ne menyre qe te vazhdoja te perfitoja mbeshetjen qeveritare. Pyetja ime lidhet me vitin aktual, perderisa nuk kam marre asnje njoftim ne lidhje me dokumente qe me duhet te dorezoj prane institucionit tuaj. Ju lutem te me informoni me proceduren qe duhet te ndjek ne menyre qe edhe per vitin aktual, te jem ne gjendje te vazhdoj te perfitoj mbeshetjen nga qeveria per programet prioritare, sic parashikohet ne VKM nr. 386, datë 01.06.2022, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, të Udhëzimit nr.30, datë 04.11.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar”, të ndryshuar. Ku uroj pune te mbare.	09.10.2025	Pershendetje Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 01.06.2022, të ndryshuar, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”; Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar; Marrëveshjes trepalëshe të nënshkruar ndërmjet Studentëve, IAL-ve dhe AKFAL-it; Ju bëjmë me dije se për studentët që vijnë në përfitojnë mbështetje financiare për vitin akademik 2025-2026, është e nevojshme të depozitoni pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë dokumentacionin si më poshtë: Listën e notave për vitin akademik 2024-2025; Vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për vitin akademik 2024-2025. Në rast se nuk plotësohet kriteri i notës mesatare, studenti humbet të drejtën e përfitimit të mbështetjes financiare për vitin akademik pasardhës. Depozitimi i dokumentacionit duhet të kryhet në një nga mënyrat e mëposhtme: fizikisht pranë zyrave të AKFAL-it, në format elektronik, në adresën: adresën e e-mailit: enkelejda.meta@arsimi.gov.al në rrugë postare, në adresën: “Rruga Naim Frashëri, Nr. 34, Tiranë”, Afati i dorëzimit të dokumentacionit , brenda datës 24.10.2025. Faleminderit për bashkëpunimin.	Përgjigjia jepet e plote	Jo

29	08.10.2025	Doja edhe t'ju informoja që unë si studentë tashmë vazhdojmë masterin. Në bazë të një emaili nga AKFAL mbështetjen ne e përfitojmë edhe në ciklik e dytë, a duhet të dorëzoj vetëm notat e vitit 3?	09.08.2025	I nderuar student, Po, ju përfitoni mbështetje financiare edhe për ciklin e dytë të studimeve (master), sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Megjithatë, në përputhje me VKM nr. 386, datë 01.06.2022, pika 4, kriteri për vijimin e mbështetjes është që mesatarja e tre viteve të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) të mos jetë më pak se 8.5. Prandaj, për të përfituar mbështetjen, ju duhet të dorëzoni mesataren e tre viteve të studimeve të ciklit të parë (Bachelor), e cila do të merret në shqyrtim për vlerësimin përfundimtar. Me respekt,	Përgjigjia jepet e plote	Jo
30	11.10.2025	Pershendetje jam student i matematikes viti 2.pyes ne lidhje me bursen prioritare a duhet te paraqes ndonje dokument ne vijim	13.10.2025	Përsëndetje Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 01.06.2022, të ndryshuar, "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë"; Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar; Marrëveshjes trepalëshe të nënshkruar ndërmjet Studentëve, IAL-ve dhe AKFAL-it; Ju bëjmë me dije se për studentët që vijojnë të përfitojnë mbështetje financiare për vitin akademik 2025-2026, është e nevojshme të depozitoni pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë dokumentacionin si më poshtë: Listën e notave për vitin akademik 2024-2025; Vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për vitin akademik 2024-2025 Në rast se nuk plotësohet kriteri i notës mesatare, studenti humbet të drejtën e përfitimit të mbështetjes financiare për vitin akademik pasardhës. Depozitimi i dokumentacionit duhet të kryhet në një nga mënyrat e mëposhtme: fizikisht pranë zyrave të AKFAL-it, në format elektronik, në adresën: adresën e e-mailit: anila.bozaxhiu@arsimi.gov.al në rrugë postare, në adresën: "Rruga Naim Frashëri, Nr. 37, Tiranë", Afati i dorëzimit të dokumentacionit , brenda datës 24.10.2025. Faleminderit për bashkëpunimin. Me respekt,	Përgjigjia jepet e plote	Jo
31	13.10.2025	Pershendetje! Jam nxenese e universitetit Fan.S.Noli ne qytetin e Korces dhe kam mbaurar vitin e dyte per arsim fillor dhe keto dy vite kam marre bursen e deges prioritare, deshiroj te dij nese duhet te dergoj ndonje liste notash dhe nje vertetim qe kam shlyer te gjitha detyrimet per vitin akademik 2024-2025 ne menyre qe te vazhdoj bursa dhe per kte vit te 3 ? Faleminderit	13.10.2025	Përsëndetje Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 01.06.2022, të ndryshuar, "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë"; Udhëzimit nr. 30, datë 04.11.2022 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar; Marrëveshjes trepalëshe të nënshkruar ndërmjet Studentëve, IAL-ve dhe AKFAL-it; Ju bëjmë me dije se për studentët që vijojnë të përfitojnë mbështetje financiare për vitin akademik 2025-2026, është e nevojshme të depozitoni pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë dokumentacionin si më poshtë: Listën e notave për vitin akademik 2024-2025; Vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për vitin akademik 2024-2024 Në rast se nuk plotësohet kriteri i notës mesatare, studenti humbet të drejtën e përfitimit të mbështetjes financiare për vitin akademik pasardhës. Depozitimi i dokumentacionit duhet të kryhet në një nga mënyrat e mëposhtme: fizikisht pranë zyrave të AKFAL-it, në format elektronik, në adresën: adresën e e-mailit: esterina.demiraj@arsimi.gov.al në rrugë postare, në adresën: "Rruga Naim Frashëri, Nr. 37, Tiranë", Afati i dorëzimit të dokumentacionit , brenda datës 24.10.2025. Faleminderit për bashkëpunimin. Me respekt,	Përgjigjia jepet e plote	Jo
32	20.10.2025	Përsëndetje, A përfiton bursë studimi për degët prioritare një student me mesatare 7.8 në degën e studimit "Gjuhë angleze" mësuesi në Universitetin "Ismail Qemali "Vlorë" ? Nëse po, të lutem mund të më orientoni më shumë rreth procedurave. Përgjigjia juaj do më ndihmonte shumë. Faleminderit!	21.10.2025	Përsëndetje, Në zbatim të Vendimit nr.7 datë 04.08.2025 të komisionit ad-hoc, për "Përcaktimin e programeve prioritare të studimit dhe kuotave të financimit për këto programe në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për vitin akademik 2025-2026" ju informoj se: Programi i studimit " Mësuesi në Gjuhën Angleze" nuk bën pjesë në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar për vitin akademik 2025-2026. Ju faleminderit	Përgjigjia jepet e plote	Jo

33	20.10.2025	Pershendetje, Jam student ne vitin e pare ne Universitetin Bujqesor te Tiranes, dega Shkenca bujqesore dhe siguri ushqimi e cila eshte nje nga degjet prioritare dhe jam i interesuar mbi data kur fillojn aplikimet per perfitimn e burses. Pres pergjigjen tuaj,faleminderit per kohen dhe konsideraten.	23.10.2025	Pershendetje, Ne mbështetje të VKM nr.386/2022, i ndryshuar ju do të aplikoni për mbështetje financiare për programet përbëjnë prioritet kombëtar nga data 22.10.2025 deri ne datën 20.12.2025. Faleminderit,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
34	21.10.2025	Pershendetje, A perfiton bursë studimi për degët prioritare një student me mesatare 7.8 në degën e studimit "Gjuhë angleze" mësuesi në Universitetin "Ismail Qemali "Vlorë ? Nëse po, të lutem mund të më orientoni më shumë rreth procedurave. Pergjigjija juaj do më ndihmonte shumë. Faleminderit!	21.10.2025	Pershendetje, Në zbatim të Vendimit nr.7 datë 04.08.2025 të komisionit ad-hoc, për "Përcaktimin e programeve prioritare të studimit dhe kuotave të financimit për këto programe në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për vitin akademik 2025-2026" ju informoj se: Programi i studimit " Mësuesi në Gjuhën Angleze" nuk bën pjesë në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar për vitin akademik 2025-2026. Ju faleminderit	Pergjigjia jepet e plote	Jo
35	23.10.2025	Pershendetje, Jam një nga studentet e Fakultetit të Mjekësisë dega mjekësi e përgjithshme viti 2, që kam nëshkuar kontratën e AKFAL për bursën e ekselencës. Me dt 9 tetor kishit dërguar një email për dorëzimin e listës së notave dhe një vërtetimi me afat deri në datën 24 tetor. Doja të sqaroja faktin nëse këto dokumente duhet të dorëzohen nga të gjithë ne që e kemi firmosur kontratën edhe nëse nuk e përfitojmë bursën këtë vit apo duhet të dorëzohet vetëm nga përfituesit e bursës për vitin 2025-2026? Shpresoj që të ktheni një përgjigje pasi këtë pyetje e kanë dhe studentët të tjerë që nuk janë të qartë për këtë çështje. Faleminderit!	23.10.2025	Pershendetje, Duke qenë se për vitin akademik 2025-2026 Ju , besoj nuk plotësoni kriterin kryesor të mesatares së kërkuar për bursën e ekselencës, nuk është e nevojshme të dorëzoni dokumentacionin (listën e notave dhe vërtetimin) brenda afatit të përcaktuar. Ju inkurajojmë të vijoni me përkushtim studimet tuaja, në mënyrë që vitin e ardhshëm të mund të jeni përfituese e bursës. Gjithashtu, ju kujtojmë të siguroheni se jeni të informuar saktë mbi kriteret për mesataren e llogaritur në universitet, pasi shpesh studentët ngatërrohen me mesataren e maturës. Ju urojmë suksese dhe forca për këtë vit akademik! Me respekt,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
36	23.10.2025	Pershendetje,une qe po ju shkruaj jam nje maturante e ketij viti qe kam fituar te drejten e medaljes se arte.Nese vitin tjeter vendos te rikonkuroj ne mjekesi dhe e nenshkruaj kontraten detyruese kur te regjistrohem e kam te drejten e burses apo jo?	24.10.2025	Pwrshendetje, Ju jeni studente në vit të parë në universitet? sepse ne emailin e nisur nga ju shkruani " vendos te rikonkuroj". Nëse ju jeni studente ekselente atehere perfitoni bursen sa paga minimale, sipas kriterit 2a te VKM nr.386/2022, i ndryshuar. "Mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit ose të ardhura të tjera të ligjshme, të studentëve shtetas shqiptarë, të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë, që nuk janë njëkohësisht përfitues të ndonjë financimi tjetër nga shteti shqiptar dhe që plotësojnë kriteret e mëposhtme: a) Studenti me notë mesatare në pranim, që: i. ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00; ii. në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00." Aplikimet per mbeshtetje financiare per vitin akademik 2025-2026 kane filluar, ato zgjasin nga data 22.10.2025-20.10.2025. Faleminderit,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
37	23.10.2025	Jam Studente e vitit te trete te bachelor ne univeritetin Luigj Gurakuqi , dega biokimi , a perfitoj burse prioritare?	27.10.2025	Pershendetje , Sipas VKM nr. 386, datë 1.6.2022, të ndryshuar, bursa prioritare përfitohet vetëm nga studentët që regjistrohen për herë të parë në një program studimi prioritar menjëherë pas përfundimit të shkollës së mesme. Duke qenë se jeni studente e vitit të tretë në Biokimi, nuk përfshihen në këtë kategori përfitimi. Faleminderit,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
38	24.10.2025	Pershendetje, Jam studente e vitit të katërt në fakultetin e Mjekësisë së Përgjithshme dhe ju shkruaj në lidhje me dokumentacionet përkatëse që kërkohen cdo vit nga AKFAL. Për fat të keq këtë vit nuk arrita dot të përbushja kriterin e mesatares ndaj dua t'ju pyes nëse janë të nevojshme dokumentet pasi pati një problem në sekretarinë e Universitetit tonë në lidhje me këtë çështje. Nëse dokumentet janë të domosdoshme për tu paraqitur ju kërkoj shumë ndjesë për vonesën pasi jam ende në pritje të një njoftimi nga sekretaria. Ju kërkoj ndjesë për shqetesimin dhe pres përgjigjen tuaj Faleminderit	27.10.2025	Pershendetje, Faleminderit që na kontaktuat. Për të vijuar me mbështetjen financiare, studentët duhet të ruajnë një mesatare të caktuar gjatë studimeve. Meqë këtë vit nuk e keni përbushur kriterin e mesatares, nuk është e nevojshme të dorëzoni dokumentacionin pranë AKFAL-it. Ju urojmë suksese në vijim të studimeve! Me respekt,	Pergjigjia jepet e plote	Jo
39	28.10.2025	Pershendetje. Jam studente ne qytetin e Durresit, ne Univeristetin Aleksander Moisiu, ne degen Gjuhe - Letersi dhe jam e interesuar te pyes neqoftese perfitoj mbeshtetje financiare. A eshte dege prioritare. Jam viti i pare. Ju lutem mund te me jepni nje informaciom me teper?	29.10.2025	Pershendetje, Në zbatim të Vendimit nr.7, datë 04.08.2025 të Komisionit ad-hoc i ngritur nga Ministria e Arsimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës nuk ka kuota për programet prioritare. Faleminderit,	Pergjigjia jepet e plote	Jo

40	29.10.2025	Pershendetje,kam nevojë të me konfirmoni një informacion. Kam përfunduar bachelorin me mesatare mbi 9. Fillova masterin shkencor i cili kushton 150.000 të reja. Vitin e pare me thane se duhet të paguaja 50% të 75.000. Tani duhet të paguaj 75.000 të plota për vitin e dytë për shkak se vitin e parë nuk më rezultoi mesatarja mbi 9.	29.10.2025	Përsëndetje, Faleminderit për kontaktimin tuaj me Agjencinë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL). Çështja e përcaktimit të tarifave të studimit për ciklin Master Shkencor dhe mënyra e aplikimit të reduktimeve apo përjashtimeve nga tarifa i përket kompetencës së institucionit të arsimit të lartë ku ju studioni. Ju sugjerojmë t'i drejtoheni zyrës së financës ose sekretarisë mësimore të universitetit përkatës për të marrë informacionin zyrtar dhe të detajuar mbi situatën tuaj. Për më shumë informacion rreth AKFAL, mund t'i drejtoheni faqes sonë zyrtare të internetit: https://akfal.gov.al/sq/ Me respekt, Përsëndetje , Aplikimi juaj për kreditë studentore është në rregull. Ne do të marrim në konsideratë vetëm një prej aplikimeve të dërguara. Faleminderit për njohëtimin!	Përgjigjia jepet c plotë	Jo
41	30.10.2025	Pershendetje , pa dashje kam shtypur butonin dergo dy here dhe kam ber dy aplikime per kredi studentore ne emrin XX . A mund qe ta fshini njerën prej tyre ju lutem ? Faleminderit !	31.10.2025		Përgjigjia jepet c plotë	Jo